VENDIM
Nr.1497, datë 19.11.2008

PËR SHTYPJEN E LETRAVE ME VLERË

(ndryshuar me VKM-të nr.150, datë 3.3.2010, nr.277, datë 6.4.2011, nr. 475, datë 25.7.2012, nr. 393, datë 18.6.2014, nr. 373, datë 21.6.2023; nr. 431, datë 19.7.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shtypja e letrave me vlerë realizohet nga Shtypshkronja e Letrave me Vlerë, sh.a, me kapital shtetëror, në varësi të Ministrit të Financave.

Kur Shtypshkronja e Letrave me Vlerë nuk ka kapacitet teknologjik për shtypjen e biletave të lojërave të fatit ato mund të shtypen në shtypshkronja brenda ose jashtë vendit, sipas një procedure të përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave.

Me pamundësi të kapacitetit teknologjik nënkuptohet mungesa e software-ve dhe hardware-ve të nevojshëm për shtypjen e biletave të lojërave të fatit.

Me marrjen e kërkesës për shtypjen e biletave të lojërave të fatit, për të cilat Shtypshkronja e Letrave me Vlerë dyshon se nuk ka kapacitetin e duhur teknologjik të shtypjes, ajo mbledh bordin drejtues, i cili analizon ekonomikisht në mënyrë të hollësishme, pamundësinë e shtypjes së këtyre biletave dhe argumenton pamundësinë e kthimit ekonomik, nëse do të investohej për blerjen e teknologjisë së munguar për këto raste. Në përfundim, bordi drejtues i Shtypshkronjës së Letrave me Vlerë merr vendim për pamundësinë e ofrimit të shërbimit, i cili i komunikohet operatorit kërkues. Në vijim, operatori mund të procedojë me nënshkrimin e kontratës për shtypjen e këtyre biletave në shtypshkronja të akredituara, brenda ose jashtë vendit, dhe vë në dijeni institucionin mbikëqyrës të aktivitetit të tij.

2. Letra me vlerë, në kuptimin e këtij vendimi, do të vlerësohen pullat fiskale, biletat e lojërave të fatit, biletat e transportit rrugor dhe atij hekurudhor, kuponët për dokumente biometrike, pullat e postës shqiptare, si dhe diplomat e maturës shtetërore, bileta, procesverbale, akte kontrolli, vendim për kundërvajtjen administrative, procesverbal i konstatimit të kundërvajtjes administrative, akt verifikimi, vendim dënimi, vërtetim transporti, bileta për hyrje në zonat e mbrojtura/parqe kombëtare për invalidë dhe automjete, fatura, raporte mjekësore, receta me rimbursim 100%, receta me rimbursim të pjesshëm, receta pa rimbursim, formularë vizite, formularët e procedurave mjekësore, rekomandime, kartela, libreza shëndetësore të lëshuara nga institucione shtetërore, si dhe dokumente të prodhuara e të lëshuara nga njësitë e qeverisjes vendore, të cilat përmbajnë numër serial .

3.Procedurat, afatet dhe çështje të tjera, që lidhen me prodhimin e letrave me vlerë, rregullohen me udhëzimin e Ministrit të Financave që do të dalë brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

4. Vendimet nr.402, datë 6.8.1993 "Për shtypjen e letrave me vlerë", dhe nr.183, datë 28.3.2007 "Për organizimin, shtypjen dhe emetimin e biletave të transportit rrugor" të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha